

ikubINFO Software Solutions shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	14,203,207	17,848,891
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	881,729	3,246,762
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	5,437,127	5,462,416
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	3,569,127	3,806,373
Shpenzime të shtyra	8	-	6,317,083
Total Aktive Afatshkurtra		24,091,190	36,681,525
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	4,842,383	6,145,830
Total aktive afatgjata		4,842,383	6,145,830
Total Aktive		28,933,573	42,827,355
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	10	312,618	425,092
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	9,856,490	1,800,000
Detyrime tatimore	12	2,144,669	1,329,956
Të ardhurat e shtyra	13	69,844	-
Të tjera detyrime	14	297,430	1,488,349
Total Detyrime afatshkurtra		12,681,051	5,043,397
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	-	658,766
Total Detyrime afatgjata		-	658,766
Totali i detyrimeve		12,681,051	5,702,163
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	16	-	-
Kapitali i nënshkruar		400,000	400,000
Rezerva ligjore		40,000	40,000
Rezerva të tjera		14,310,992	36,492,295
Fitimi i ushtrimit		1,501,530	192,897
Total kapitali aksionar		16,252,522	37,125,192
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		28,933,573	42,827,355

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	21,814,734	20,654,683
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	422,334	892,822
			-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(9,102,632)	(9,666,071)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(7,121,133)	(5,205,015)
2) Të tjera shpenzime	20	(1,981,499)	(4,461,056)
			-
Shpenzime të personelit	21	(9,944,564)	(9,732,688)
1) Paga dhe shpërblime		(9,538,498)	(8,912,288)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pension)		(406,066)	(820,400)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(1,337,699)	(1,630,663)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(41,391)	(5,005)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare		(29,136)	(77,853)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	23	(29,136)	(87,914)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	10,061
Fitimi/humbja para tatimit		1,781,646	435,225
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(280,116)	(242,328)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(280,116)	(242,328)
Fitimi/humbja e vitit		1,501,530	192,897
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			

“ikubINFO Software Solutions” shpk

(Vlerat janë në Lek)

Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	1,501,530	192,897
---	------------------	----------------

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"ikubINFO Software Solutions" shpk


(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	400,000	40,000	37,491,487	(999,192)	36,932,295
Fitimi / Humbja e vitit				192,897	192,897
Lëvizjet përmes kapitalit			(999,192)	999,192	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	400,000	40,000	36,492,295	192,897	37,125,192
Fitimi / Humbja e vitit				1,501,530	1,501,530
Lëvizjet përmes kapitalit			192,897	(192,897)	-
Dividendë të paguar			(22,374,200)		(22,374,200)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	400,000	40,000	14,310,992	1,501,530	16,252,522

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori ikubINFO Software Solutions shpk më 21.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.


Romeo SHERKO
Administrator




Algert BREGU
Hartuesi i Pasqyrave Financiare

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	1,501,530	192,897
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(702,656)	(443,682)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	237,245	191,187
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,337,699	1,630,663
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	8,777,249	5,432,738
Rënie/(rritje) në inventarë	-	4,168
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	8,758,729	552,816
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(1,190,919)	947,221
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	18,718,877	8,508,008
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(34,251)	(988,846)
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		120,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(34,251)	(868,846)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(658,766)	(619,415)
Dividendë të paguar	(22,374,200)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(23,032,966)	(619,415)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(4,348,340)	7,019,747
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	17,848,891	10,385,462
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	702,656	443,682
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor	4 14,203,207	17,848,891

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ikubINFO Software Solutions" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 20/03/2007. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 400,000 leke i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

Administrator i shoqërisë është Z.Romeo Sherko.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Ismail Qemali, Pallati 27, Shk1, Nr. 30, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degën e Tatimeve, Tiranë me NIPT K71702025M.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është " Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ".

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 7 punonjës (2014: 8 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvierësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvierësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohej nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë

(Vlerat janë në Lek)

nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuara duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuara sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme

3. Politikat Kontabël

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

(Vlerat janë në Lek)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	13,440,858	16,957,639
<i>Llogari rrjedhëse</i>	13,440,858	16,957,639
Mjete monetare në arkë	762,349	891,252

“ikubINFO Software Solutions” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

14,203,207

17,848,891

5. Llogari të arkëtueshme tregëtare

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Klientë	881,729	3,246,762
	<u>881,729</u>	<u>3,246,762</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
ikubINFO shpk Të arkëtueshme tregëtare	-	181,582
Intelligent Systems Albania Të arkëtueshme tregëtare	576,181	419,888
Investment Sherko Të arkëtueshme të tjera	83,000	83,000
ikub.al Të arkëtueshme të tjera	1,298,350	1,298,350
Intelligent Systems Albania Të arkëtueshme të tjera	3,479,596	3,479,596
	<u>5,437,127</u>	<u>5,462,416</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Tatim mbi fitimin	1,304,223	1,541,469
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	2,264,904	2,264,904
	<u>3,569,127</u>	<u>3,806,373</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet për periudhat e ardhshme më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
ikubINFO shpk shërbime programimi	-	6,290,000
AKEP për rinovim domaini	-	27,083
	<u>-</u>	<u>6,317,083</u>

“ikubINFO Software Solutions” shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	4,960,810	220,964	3,766,760	3,443,590	12,392,124
Shtesa	0	0	988,846	0	988,846
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	4,960,810	220,964	4,755,606	3,443,590	13,380,970
Shtesa	0	0	34,251	0	34,251
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	4,960,810	220,964	4,789,857	3,443,590	13,415,221
Zhvlerësimi i akumuluar					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	(2,091,506)	(71,496)	(1,983,855)	(1,457,620)	(5,604,477)
Amortizimi i vitit	(573,861)	(29,893)	(629,715)	(397,194)	(1,630,663)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	(2,665,367)	(101,389)	(2,613,570)	(1,854,814)	(7,235,140)
Amortizimi i vitit	(459,088)	(23,915)	(536,940)	(317,755)	(1,337,698)
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	(3,124,455)	(125,304)	(3,150,510)	(2,172,569)	(8,572,838)
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	2,869,304	149,468	1,782,905	1,985,970	6,787,647
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,295,443	119,575	2,142,036	1,588,776	6,145,830
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,836,355	95,660	1,639,347	1,271,021	4,842,383

“ikubINFO Software Solutions” shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Furnitorë	295,925	317,868
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	<u>16,693</u>	<u>107,224</u>
	<u>312,618</u>	<u>425,092</u>

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Intelligent Systems Albania	1,800,000	1,800,000
ikub.al	56,490	-
Dividentë të pagueshëm	<u>8,000,000</u>	<u>-</u>
	<u>9,856,490</u>	<u>1,800,000</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	52,835	97,354
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	1,118,644	351,032
Tatim ne Burim	7,310	-
TVSH për t'u paguar	<u>965,880</u>	<u>881,570</u>
	<u>2,144,669</u>	<u>1,329,956</u>

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Të ardhura të periudhave të ardhëshme	<u>69,844</u>	<u>-</u>
	<u>69,844</u>	<u>-</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Detyrime ndaj personelit	297,430	1,488,349
	<u>297,430</u>	<u>1,488,349</u>

15. Hua afatgjata

Ne kete ze eshte paraqitur detyrimi qe ka shoqeria ndaj Tirana Leasing per qirane financiare per automjete. Me poshte eshte paraqitur ky detyrim per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2015 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 :

	<u>31 Dhjetor 2015</u> <u>ne Lek</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u> <u>ne Lek</u>
Tirana Leasing - Qera financiare	-	658,766
	<u>-</u>	<u>658,766</u>

16. Kapitali aksionar

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 400,000 leke i zoteruar 100% nga ortaku i vetem i shoqerise Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur</u> <u>më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur</u> <u>më 31 Dhjetor 2014</u>
Shërbime programimi	1,130,400	8,051,495
Shërbime mirëmbajtje	6,066,390	7,904,118
Zhvillim software	6,510,800	1,349,120
Të ardhura GIS	8,107,144	3,349,950
	<u>21,814,734</u>	<u>20,654,683</u>

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Fitime nga këmbimet valutore	852,568	463,972
Humbje nga këmbimet valutore	(658,261)	(89,405)
Të ardhura qera serveri server	130,244	349,907
Të ndryshme	97,783	168,348
	<u>422,334</u>	<u>892,822</u>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	<u>Dhjetor 31, 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	22,112,605
Të ardhurat e shtyra	(69,844)
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>22,042,761</u>
Shërbime	22,042,761
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	<u>22,042,761</u>
Të ardhurat nga interesat	1,051
Fitim nga këmbimet valutore	852,568
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	<u>22,896,380</u>

19. Lëndet e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Nënkontraktime	6,290,000	5,205,015
Shërbim konsulence	831,133	-
	<u>7,121,133</u>	<u>5,205,015</u>

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Qira Zyra	592,314	558,718
Trajnime	-	683,500
Reklama në internet	702,803	754,421
Shërbime konsulence	83,776	126,092
Shërbime telefonike+internet+postare	213,351	388,043
Komisione bankare	115,061	73,288
Taksa vendore	25,120	25,120
Blerje kancelari dhe të ngjashme	7,400	52,706
Shpenzime udhëtimi e dieta	-	41,877
Konsum ujë i pijshëm	64,000	72,900
Tarifa AKEP	79,987	30,000
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	97,687	1,654,391
	<u>1,981,499</u>	<u>4,461,056</u>

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime për paga	4,762,693	7,562,288
Shpërblime për punonjësit	4,775,805	1,350,000
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	406,066	820,400
	<u>9,944,564</u>	<u>9,732,688</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 7 (2014:8).

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015 ne Lek</u>	<u>31 Dhjetor 2014 ne Lek</u>
Gjoba dhe penalitete	41,391	5,005

“ikubINFO Software Solutions” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

<u>41,391</u>	<u>5,005</u>
---------------	--------------

23. Shpenzime financiare Neto

	<u>Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Shpenzime Interesa të Qerasë Financiare	(30,187)	(93,755)
Shpenzime interesa banka	-	(21)
Të ardhura nga interesat	1,051	5,862
Të ardhura të tjera financiare	-	10,061
	<u>(29,136)</u>	<u>(77,853)</u>

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2014;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	1,781,646	435,225
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	85,791	1,180,296
Shpenzime pritje & përcjellje	40,800	
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	41,391	5,005
Shpenzime të tjera	3,600	1,175,291
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	1,867,437	1,615,521
	1,867,437	1,615,521
<i>Tatim fitimi @15%</i>	280,116	242,328
Fitimi/humbja e Vitit	1,501,530	192,897

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
ikubINFO shpk	-	181,582
Intelligent Systems Albania	576,181	419,888
Investment Sherko	83,000	83,000
ikub.al	1,298,350	1,298,350
Intelligent Systems Albania	3,479,596	3,479,596
	5,437,127	5,462,416
	-	-
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Intelligent Systems Albania	1,800,000	1,800,000
ikub.al	56,490	-
Investment Sherko Dividentë	8,000,000	-
	9,856,490	1,800,000
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<i>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</i>		
<i>Shitje palëve të lidhura</i>		
ikubINFO	8,907,119	9,828,741
Intelligent Systems Albania	130,244	349,907
	9,037,363	10,178,648
<i>Blerje nga palët e lidhura</i>		
ikubINFO	-	5,100,000
ikub.al	702,803	754,421
	702,803	5,854,421

26. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkoje rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

27. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.